



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 368 Prot.

Korçë, më 16.01.2025

URDHËR
Nr. 25 Datë 16.01.2025

PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK QË ORGANIZOHEN OSE BASHKËORGANIZOHEN NGA BASHKIA KORÇË

Bazuar në nenin 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe në vendimin e Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e më kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelles dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Të gjitha veprimtaritë me karakter publik që do të organizohen ose bashkëorganizohen nga Bashkia Korçë në periudhën 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, të raportohen në Ndërfaqja Elektronike e Raportimit të Institucioneve (NRI).
2. Të gjitha drejtoritë, sektorët, ndërmarrjet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Korçë dhe sh.a në të cilat Bashkia Korçë zotëron mbi 50% të aksioneve, të cilat organizojnë aktivitete ose veprimtari publike, duhet të njoftojnë Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të paktën 7 (shtatë) ditë para zhvillimit të saj.
3. Raportimi duhet të përmbajë, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, Bashkinë, adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, qëllimi dhe tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online ose jo.
4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen të gjitha drejtoritë, sektorët, ndërmarrjet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Korçë, “Qendra Sportive Korçë” sh.a, “Korça 2008” sh.a dhe “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime Korçë” sh.a.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo

